| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Municipality of Istog |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.124/2018 | Data:<br>31.10.2018 | |

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, dhe nenit 45.4 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive publike, Nr.03/L-048, në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2018. Shqyrtoj Raportin Financiar për tre mujorin e tretë korrik- shtator të vitit fiskal 2018 dhe mori këtë:

# VENDIM
## RAPORTIN FINANCIAR PËR TRE MUJORIN E TRET KORRIK- SHTATOR TË VITIT FISKAL 2018

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë dhe debatoj Raportin Financiar për tre mujorin e tretë korrik- shtator të vitit fiskal 2018, pa vërejtje.

2. Raporti Financiar i paraqitur në formë tabelore është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.

4. Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, ZKF dhe një kopje në arkivin e këtij Kuvendi.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Dales-Izlazna
Nr/Br: 01-039-9 Data/Datum 6.11.2018
ISTOG-ISTOK

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Qaush Balaj

| | | |
|---|---|---|
| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | **KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY**<br>**01 Nr.125 /2018** — **Data: 31.10.2018** | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 58 pika h). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 18 nënparagrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal, në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2018, shqyrtoi: Propozim-Vendimin për futjen e Komunës së Istogut në kuadër të marrëveshjes për ndërkombëtare Klimë dhe Energji dhe mori:

**VENDIM**
**PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE PËR KLIMË DHE ENERGJI**

1. Autorizohet Kryetarit i Komunës z. Haki Rugova të nënshkruaj marrëveshjen ndërkombëtare për Klimë dhe Energji.

2. Projekt Menaxher caktohet z.Osman Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e kësaj marrëveshje.

3. Ky Vendim u votua unanimisht nga anëtarët e Asamblesë Komunale.

4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në web faqen zyrtare të komunës, për zbatimin e tije është përgjegjës Kryetari i Komunës.

5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Ulas-izlazna
Nr: 01-039-9 Data 6.11.2018
Br: Datum
ISTOG-ISTOK

**KRYESUESI I KUVENDIT,**
**z. Qaush Balaj**

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Municipality of Istog |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.126 /2018 | Data:<br>31.10.2018 | |

Kuvendi i Komunës së Istogut, në pajtim me nenin 34.2. të Statutit të Komunës, 01Nr.55/14 dhe nenit 10 paragrafi 4 të Rregullore për Punën e Kuvendit të Komunës së Istogut (Rregullorja Komunale Nr. 3/2014) në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2018, shqyrtoi Projekt Rregulloren për tatimin në pronë, dhe mori këtë:

**VENDIM**
**SHPALLJA NË DISKUTIM PUBLIK**

1. Hapet diskutimi publik për Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për tatimin në pronë.

2. Diskutimi publik për projekt-rregulloret e cekura më lartë, do të jetë i hapur prej 31.10.2018 deri më 19.11.2018.

3. Projekt-Rregullorja është e ekspozuara në Sallën e Kuvendit të Komunës, në Istog, për çdo ditë pune prej orës 08oo deri në orën 16oo.

4. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, qe t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë projekt-rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën II. të këtij Vendimi.

5. Për çdo informatë të interesuarit mund t'i drejtoheni Asistentes së KK-së, zyra nr. 305, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

6. Ky Vendim të shpallet: në tabelën e shpalljeve, në mjetet e informimit elektronik dhe në Web faqen e Komunës së Istogut, me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës së Istogut.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Dales-Izlazna
Nr/Br: 01-039-9 Data/Datum: 6-11-2018
ISTOG-ISTOK

**KRYESUESI I KUVENDIT,**
**z. Qaush Balaj**

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPŠTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | | Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.127 /2018 | Data:<br>31.10.2018 | |

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 58 pika h). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 6 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Nder komunal dhe nenit 5 paragrafi 1.1 dhe Rregullores Nr.09/2013 miratohet marrëveshja e Bashkëpunimit Nder komunal, në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2018, bazuar në Vendimin 01Nr.43/2018 të datës 30.04.2018 të Nismës për bashkëpunim nderkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mori:

**VENDIMI**
**PËR MIRATIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL**
**NË FUSHË E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË**

1. Miratohet marrëveshja për Bashkëpunimi nder komunal në fushë e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë e nënshkruar nga kryetaret e Komunave:

    1. Komuna e Istogut,
    2. Komuna e Pejës,
    3. Komuna e Malishevës dhe
    4. Komuna e Klinës.

2. Ky Vendim për zbatimin e marrëveshjes për bashkëpunim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në web faqen zyrtare të komunës, për zbatimin e tije është përgjegjës Kryetari i Komunës.

3. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Dales-Izlazna
Nr: 01-039-9 Data 6.11.2018
Br: Datum
ISTOG-ISTOK

**KRYESUESI I KUVENDIT,**
**z. Qaush Balaj**